# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436988**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Banesat pa pronar - Avokati: Në emër të kujt bëhet legalizimi? Hiqen pengesat e gjykatave |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/ekonomia/banesat-pa-pronar-avokati-ne-emer-te-kujt-behet-legalizimi-hiqen-penges-i585436` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 14:22:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 15:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `80ca04b73d001c67f828da837d147501ff56a6a4644bfbc57a60b89d4c8eff3c` |
| TEKSTI | `ce2c6030946d8bd2e4a3942a826f0926f495bbd4851f319536f99d0bfa2218dd` |
| PAMJA | `38fe8111c638275d6f469e3f7fe0de933015ed706e45b91623b374d698a1e0a2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `24f8829e8adfe94872a8771d18eead91745bb710977a61bd6767b1b9946bcb5a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/24f8829e8adfe94872a8771d18eead91745bb710977a61bd6767b1b9946bcb5a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Banesat pa pronar - Avokati: Në emër të kujt bëhet legalizimi? Hiqen pengesat e gjykatave

11 Shtator 2026, 17:30Ekonomia TEMA

Banesat pa pronar - Avokati: Në emër të kujt bëhet

Banesat që kanë më shumë se një pretendim për pronësinë, do të hyjnë në procesin e legalizimit, pavarësisht se nuk ka një vendim gjykate që përcakton pronarin e saj. Në një intervistë për SCAN, Avokati Fabjan Mehmeti, sqaron risitë e draftligjit, ndërsa thekson se në këtë rast legalizimi do kryhet pa një emër pronari dhe pas vendimit të gjykatës, prona do t'i kalojë në pronësi atij që ka fituar gjyqin.

"Shumë prona të cilat nuk janë të legalizuara do të legalizohen por pa emër pronari në procesin e legalizimit dhe do të pritet deri në momentin kur konflikti të zgjidhet midis ndërtuesit dhe poseduesit ose personave të tretë në gjykatë. Për shembull ta thjeshtësojmë, nëse për një njësi tregtare ose apartament ka mosmarrëveshje, në rast kur apartamenti është shitur tre herë për shembull dhe mosmarrëveshja qëndron në gjykatë. Kjo pronë do të legalizohet dhe do të rrijë pa pronar, dhe do të pritet përfundimi i procesit gjyqësor. Në momentin kur gjykata të përcaktojë të drejtën e pronësisë midis tre palëve që janë në gjyq, atëherë në bazë të vendimit të gjykatës legalizimi do të ketë emrin e pronarit. Akti i legalizimit do të ketë emrin e pronarit. Kjo është një risi shumë e rëndësishme pasi kërkon që t'i japë fund procesit të legalizimeve dhe të mos presë përfundimin e proceseve gjyqësore të cilat zgjasin me vite."

Nga ana tjetër, eksperti ndalet edhe tek ndryshimet ligjore që lidhen për përshpejtimin e procesit të legalizimeve kur ekziston një plan zhvillimor, duke theksuar përfitimet që do të kenë qytetarët.

"Kjo është një risi e ligjit, e ndryshimeve ligjore dhe kuadrit legjislativ që parashikohet të hyjë së shpejti në fuqi dhe i jep të drejtën poseduesit të ndërtimit pa leje ta legalizojë dhe të jetë pronari i truallit ose i ndërtimit pa leje dhe në këtë mënyrë kur projekti që është parashikuar, projekt publik që është parashikuar në atë zonë të bëhet konkret, pronari që e ka legalizuar ndërtesën, ndërtimin pa leje, të ketë mundësi të shpronësohet. Domethënë të përfitojë nga prona që ai ka poseduar. Ka ndërtuar pa leje absolutisht, por që e ka poseduar në mënyrë të rregullt dhe shteti i ka dhënë të drejtën që ta legalizojë. Shpallet pronar dhe përfiton të drejtën e shpronësimit. Domethënë nuk e humbet pronën, sepse projekti publik ka prevalencë mbi të gjitha ndërtimet dhe shteti ka të drejtë që me procesin e shpronësimeve të shpronësojë çdo lloj prone. Hyn në marrëdhënie private me pronarët, posedues të ligjshëm dhe i shpronëson. Në këtë rast ne nuk kemi një pronar posedues të ligjshëm dhe me anë të këtij aplikimi brenda 30 ditëve, kjo është procedura e legalizimit të përshpejtuar, subjekti, individi shpallet pronar, bëhet pronar dhe përfiton të drejtën e shpronësimit më mbrapa. Patjetër që është e mundur sepse varet nga vullneti i institucioneve dhe angazhimi që do kërkohet, por si proces është teknikisht i mundur."

Referuar të dhënave zyrtare nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, gjatë periudhës 2006–2025, pra në një hark kohor prej 19 vitesh, Drejtoritë Vendore të ASHK-së kanë kryer verifikimin teknik dhe ligjor të aplikimeve për legalizim, duke përfunduar me 291,114 vendime përfundimtare, dhe 6,082 aplikime të skualifikuara, për shkak të mosplotësimit të kritereve ligjore. Pra e thënë ndryshe, në këtë periudhë janë legalizuar mbi 285 mijë ndërtesa informale.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

OTP Bank Albania zgjeron rrjetin e degëve në Tiranë me hapjen e një dege moderne në Rrugën e Kosovarëve

16:19 Ekonomia

Shqipëria marrëveshje të reja me Gjermaninë, Karakaçi: 110 milionë euro investime në konvikte, Vaun e Dejës dhe digjitalizimin e nënstacioneve elektrike

14:00 Ekonomia / 4 komente

FMN qendër për integrimin e shteteve ballkanike

13:10 Ekonomia / 1 koment

Furnizimi me gaz/ Shqipëria nënshkruan marrëveshje me kompaninë amerikane, pritet ndërtimi në bregdet i një terminali me kapacitet deri në 5 milionë tonë në vit

21:25 Ekonomia / 8 komente

Ministri Salla nga Shkolla Profesionale Bujqësore e Golemit: Të rinjtë të zgjedhin arsimin profesional dhe bujqësinë

20:48 Ekonomia

Raporti/ Turistët shpenzuan në Shqipëri 2.3 miliardë euro në gjysmën e parë të vitit!

20:15 Ekonomia

Sejko, takim me BERZH - Fokus te kreditimi, bizneset e vogla dhe integrimi në BE

14:25 Ekonomia

Banesat pa certifikatë pronësie - Kadastra, "derë më derë". Si do kryhet procesi i verifikimit?

13:55 Ekonomia / 5 komente

Çmimet e gazit në Evropë rriten në nivelet më të larta që nga viti 2023

20:10 Ekonomia / 1 koment

Durrësi zgjeron kanalizimet - Karakaçi: 85 milionë euro grant europian për impiantin dhe rrjetet e ujërave të ndotura

17:00 Ekonomia / 2 komente

**Më të lexuarat**

### 24 oret e fundit

### Javen e fundit

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 22 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 30 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” m...**

15:30 Dossier / 13 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve**

13:50 Blog / 13 komente

**Ministrja që Rama po kërkon**

12:40 Blog / 13 komente

**Demokracia, jo më si vlerë lirie**

12:30 Blog / 6 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.